



FEDERATA E BADMINTONIT E KOSOVËS
BADMINTON SAVEZ KOSOVO
BADMINTON FEDERATION OF KOSOVO

Tel&Fax+ 383 132 917 +383-44-211-434;
Shtëpia e sporteve Rr.“Agim Ramadani” pn, 10000 Prishtinë
www.badminton-rks.org, email:b.f.kosovo@gmail.com

Field Code Changed

RREGULLORE E PUNËS SË KUVENDIT TË FEDERATËS SË BADMINTONIT TË KOSOVËS

~~2022~~2025

Në përputhje me nenin 15 paragrafit 2, nën paragrafin 2.1. si dhe paragrafit 24 të Statutit të Federatës së Badmintonit të Kosovës, Kuvendi i Federatës së badmintonit të Kosovës, në mbledhjen e datës: 05.11.2022===== miratoi këtë:

RREGULLORE E PUNËS SË KUVENDIT TË FEDERATËS SË BADMINTONIT TË KOSOVËS

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Rregullore, përcaktohet mënyra e punës, rregullat dhe procedurat e punës së Kuvendit të Federatës së Badmintonit të Kosovës si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Kuvendit.

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregullore janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët e Federatës së Badmintonit të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm “anëtarët e BFK-së”), Kuvendin, Bordin Ekzekutiv si dhe personat tjerë të cilët janë subjekt apo marrin pjesë në mbledhjet e Kuvendit të BFK-së.

Neni 3

Kuvendi

Kuvendi është organi më i lartë drejtues i BFK-së, i cili detyrat dhe përgjegjësitë i ka të përcaktuara në nenin 15 të Statutit të Federatës së Badmintonit të Kosovës.

Neni 4

Mbledhjet e Kuvendit

1. Kuvendi kryen punën e tij dhe vendos në mbledhjet e veta.
2. Mbledhjet e Kuvendit mund të jenë të:
 - 2.1. rregullta;
 - 2.2. jashtëzakonshme;
 - 2.3. solemne, dhe
 - 2.4. zgjedhore.
3. Në përputhje me nenin 15 paragrafi 5 të Statutit, Kuvendi mblidhet së paku një herë në vit.
4. Në çdo katër vite mbahet Kuvendi zgjedhor.
5. Mbledhjet e Kuvendit si rregull mbahen me prezencë fizike. Sipas nevojës, për çështje të caktuara Kuvendi mund të vendosë ta mbaj mbledhjen e saj në mënyrë elektronike.
6. Mbledhjet e Kuvendit janë publike.

7. Përjashtimisht nga paragrafi 6 i këtij neni, Kuvendi mund të vendos që një mbledhje e caktuar të jetë e mbyllur për publikun ose të mbahen pa praninë e përfaqësuesve të mediave.

Neni 5 **Thirrja e mbledhjeve**

1. Mbledhjet e rregullta, zgjedhore dhe solemne i thërret Kryetari i Federatës. Njoftimi për vendin dhe kohën e takimit dërgohet në përputhje me nenin 15 paragrafi 7 të Statutit.
2. Mbledhja për Kuvendin e jashtëzakonshëm mund të thirret nga Bordi Ekzekutiv në përputhje me nenin 15 paragrafi 20, 21 dhe 22 të Statutit. Kërkesa me shkrim duhet të përmbaj çështjen dhe arsyeshmërinë për mbledhjen e jashtëzakonshme.
3. Kryetari i BFK-së udhëheq mbledhjet e Kuvendit.

Neni 6 **Njoftimi për mbledhje**

1. Njoftimi për mbledhje, detajet për vendin, kohën dhe pikat e rendit të ditës së bashkume materialin për shqyrtim, dërgohen përmes postës ose email tek:

- 1.1. Secili anëtar i BFK-së;
- 1.2. Secili anëtar i Bordit Ekzekutiv;
- 1.3. Anëtarët e nderit;
- 1.4. Anëtarët e Komiteteve dhe Komisioneve të BFK-së;
- 1.5. Përfaqësuesve të Ministrisë përkatëse për Sport;
- 1.6. Përfaqësuesve të Komitetit Olimpik të Kosovës;

2. Njoftimi për vendin dhe kohën e mbledhjes dërgohen në përputhje me nenin 15 paragrafi 7 dhe 8 të Statutit.

2.3. Lidhur me mbledhjen e jashtëzakonshme duhet të plotësohet procedura e paraparë në nenin 15 paragrafi 20 i statutit.

Neni 7 **Procedura**

1. Agjenda e mbledhjes së Kuvendit përmban:

- 1.1. Verifikimin e të pranishmëve;
- 1.2. caktimin e procesmbajtësit;
- 1.3. procesverbalin e mbledhjes së kaluar të Kuvendit të BFK-së;
- 1.4. shqyrtimin e aplikimeve për anëtarësim;
- 1.5. shqyrtimin e raportit të përgjithshëm vjetor, duke përfshirë raportet e Bordit Ekzekutiv;
- 1.6. shqyrtimin e raporteve nga komitetet dhe komisionet e BFK-së;
- 1.7. shqyrtimin e raportit financiar, raportit të auditimit;
- 1.8. shqyrtimin e buxhetit të vitit paraprak dhe shqyrtimi i propozim buxhetit për vitin

kalendarik;

- 1.9. shqyrtimin e projekt akteve juridike të BFK-së;
- 1.10. shqyrtimin e nominimeve për pozita përkatëse në Federatën e badmintonit të Kosovës
- 1.11. shqyrtimi i propozimeve përcaktimit të datë për mbledhjen e radhës të Kuvendit;
- 1.12. çështje të tjera.
- 1.13. shqyrtimin e raportit të përgjithshëm vjetor, duke përfshirë raportet e Bordit Ekzekutiv;
- 1.14. shqyrtimin e raporteve nga komitetet dhe komisionet e BFK-së;
- 1.15. shqyrtimin e raportit financiar, raportit të auditimit;
- 1.16. shqyrtimin e buxhetit të vitit paraprak dhe shqyrtimi i propozim buxhetit për vitin kalendarik;
- 1.17. shqyrtimin e projekt akteve juridike të BFK-së;
- 1.18. shqyrtimin e nominimeve për pozita përkatëse në Federatën e badmintonit të Kosovës
- 1.19. shqyrtimi i propozimeve përcaktimit të datë për mbledhjen e radhës të Kuvendit;
- 1.20. çështje të tjera.

2. Anëtarët e BFK-së, kanë të drejtën e propozimit të pikave shtesë për mbledhjen e Kuvendit të ftuar jo më vonë se 15 ditë para datës së mbledhjes së Kuvendit. Propozimi duhet të jetë me shkrim dhe përmbaj një arsyeshmëri i cili dërgohet tek Sekretari i Përgjithshëm. Anëtarët e Kuvendit, në fillim të mbledhjes vendosin për përfshirje apo jo të propozimit të anëtarit në agjendën e mbledhjes së Kuvendit.

3. Anëtarët e BFK-së, kanë të drejtën e propozimit të pikave shtesë për mbledhjen e Kuvendit të ftuar jo më vonë se 15 ditë para datës së mbledhjes së Kuvendit. Propozimi duhet të jetë me shkrim dhe përmbaj një arsyeshmëri i cili dërgohet tek Sekretari i Përgjithshëm. Anëtarët e Kuvendit, në fillim të mbledhjes vendosin për përfshirje apo jo të propozimit të anëtarit në agjendën e mbledhjes së Kuvendit.

4. Një folës ka të drejtën që njëherë të flasë për një propozim ose një çështje të cilën e propozon. Përfshirja mund të bëhet në rastin kur kërkohet replika apo përgjigje për një çështje. Kryetari mund të lejoj një folës të flasë më shumë se një herë varësisht nga situata.

5. Kryetari vendos ~~kujti ti jepet fjala për numrin e folësve që do të lejohen të flasin~~ për një propozim apo pikë të rendit të ditës.

6. Pas përfundimit të diskutimeve për çdo pikë të rendit të ditës, Kuvendi merr vendim për çështjen.

7. Votimi, përveç në zgjedhje, do të bëhet me një ngritje dore apo me pajisje elektronikeose me votim të fshehtë, siç vendoset nga Kuvendi me një propozim nga Kryetari i Kuvendit;

8. Në rastet e votimit të fshehtë, tre (3) delegat do të emërohen, për miratim nga Kuvendi, për të vepruar në cilësinë e komisionit verifikues;

Neni 8

Kourumi dhe vendimarrja

1. Kuvendi mbahet nëse verifikohet se ekziston një kuorum prej më shumë se gjysma(1/2) e delegatëve të pranishëm me të drejtë përfaqësimi dhe me të drejtë vote.
2. Çdo Anëtar i regjistruar në Federatën e badmintonit të Kosovës me certifikatë përkatëse të OJQ-së dhe i cili ka përfunduar garat ekipore në vitin paraprak (i përfaqësuar përmes delegatit të emëruar në Kuvend) e ka të drejtën e tre (3) vote në Kuvend.
3. Votimi mund të iniciohet nëse verifikohet prezenca e shumicës së delegatëve 50% +1 me të drejtë vote.
4. Vendimarrja për tu zgjedhur në cilëndo pozitë të organeve në Kuvend, për ndryshimet përkatëse në Statut si dhe shpërbërjen e BFK-së përcaktohet në përputhje me nenin 15 paragrafin 12 dhe 13 të Statutit.
5. Mënyra e votimit dhe aspektet tjera të votimit përcaktohen në nenin 15 të Statutit.

Neni 9

Procesverbali

Në përputhje me nenin 7 paragrafi 1.2. të kësaj rregullore, për tërë rrjedhën e mbledhjes së Kuvendit mbahet procesverbali, të cilin e nënshkruan kryetari ose kryesuesi i mbledhjes së Kuvendit dhe procesmbajtësi.

Neni 10

Të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Kuvendit

1. Çdo anëtarë ka të drejtë të marrë pjesë në Kuvend apo të caktoj një përfaqësues në përputhje me nenin 15 paragrafi 3 të Statutit.
2. Anëtarët e BFK-së, janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhjet e Kuvendit.
3. Zgjedhja në cilindo organ të apo pozitë të BFK-së është e përcaktuar në Statut.

Neni 11

Të drejtat dhe përgjegjësitë e Kryetarit

1. Të drejtat dhe përgjegjësitë e Kryetarit të BFK-së përcaktohen në Statut.
2. Kryetari nënshkruan aktet e përgjithshme të cilat i miraton Kuvendi.

Neni 12

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja e Punës së Kuvendit të Federatës së Badmintonit e vitit ~~2018~~ 2022.

Neni 13
Aplikimi i dispozitave të Statutit

Dispozitat e kësaj Rregullore zbatohen në pajtim me dispozitat e Statutit të Federatës së Badmintonit.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi, shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Kryetari i Federatës së Badmintonit të Kosovës dhe publikimit në faqen zyrtare të BFK-së.

Përfaqësues i autorizuar i [Federatës së badmintonit të Kosovës BFK-së](#)



Prishtinë

~~05.11.2022~~ – [26.03.2025](#)

Lulzim Haziri, (Kryetar)